



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**PKR.nr.138/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** sipas Kryetarit të Trupit Gjykues Kreshnik Radoniqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Gjyljeta Çorkadiu, në lëndën penale kundër të pandehurve I. H. dhe Sh. I., që të dy nga Peja, të akuzuar secili veç e veç për vepër penale *përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 375 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.142/16 të datës 24.06.2016, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.09.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sahide Gashi, të pandehurit I. H. dhe mbrojtësit të tij avokat Z. B., dhe të pandehurit Sh. I. dhe mbrojtësit të tij avokat A.Sh., me datë 20.09.2016 murr dhe publikisht shpalli, dhe të njëjtën ditë e përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të pandehurit

- 1. I. H.** i lindur me datë .... në Pejë, i biri i H. dhe N. e lindur M., me banim në rrugën “M.Z” nr. .. në Pejë, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e ..., i gjendjes së ... ekonomike, i dënuar më parë nga ana e gjykatës për vepër penale armëmbajtje pa leje, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. Sh. I.** i lindur me datë ..... në Pejë, i biri i Z. dhe N. e gjinisë A., me vendbanim në Pejë në rrugën “W C” nr. ... dhe në Prishtinë lagjja “B i D” Banesat e ....., me numër personal ....., ka të kryer shkollën e ....., punon si ....., gjendjes së .... ekonomike, i pa dënuar nga ana e gjykatës, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**Për shkak se:**

**I pandehuri I. H.**

1. Me datë 18.04.2016, rreth orës 00:20, në Deçan, në rrugën “Luan Haradinaj”, ka përdori armën që është në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe atë pistoletën e llojit “SIG SAUER P 226”, me numër serik Z5292, prodhim zviceran me kalibër 9x19 mm, në at mënyrë që gjersa i pandehuri I së bashku me të pandehurin Sh dhe pasagjer të tjerë shin duke u kthyer nga Deçani me automjetin të cilin e ngiste E. B.-këtu dëshmitar, nga dritarja e veturës i pandehuri I shtie me armën e lartcekur disa herë në ajër.

- me çka ka kryer veprë penale *përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

### **I pandehuri Sh. I.**

2. Me datë 18.04.2016, rreth orës 00:20, në Deçan, në rrugën “Luan Haradinaj”, ka përdori armën që është në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët dhe atë pistoletën e llojit “Çeshka Zbrojevka”, me numër serik 722276, prodhim çekoslovak, me kalibër 7.65 Br S & B 15, në atë mënyrë që gjersa i pandehuri Sh bashkë me të pandehurin I dhe pasagjerë të tjerë ishin duke u kthyer nga Deçani me automjetin e tipit “ Range Rover” të cilin e ngiste E B.-këtu dëshmitar, nga dritarja e veturës i njëjti shtie me armën e lartëcekur disa herë në ajër,

- me çka ka kryer veprë penale *përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42 par. 1 nën par. 1.1, 43 par. 1 nën par. 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, 75 dhe 375 par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par 1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6, 453 par. 4 të KPPRK-se, i

## **GJYKON**

### **1. Të pandehurin I. H.**

Me **dënim me burg** në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në **dënim me gjobë** në shumë prej **2,000 (dymijë) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **2. Të pandehurin Sh. I.**

Me **dënim me burg** në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në **dënim me gjobë** në shumë prej **2,000 (dymijë) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 100 (njëqind) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri lirohet nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale, meqenëse i njëjti është pensionist invalidor i UÇK-së.

\*\*\*

Ndaj të pandehurve **I. H.** dhe **Sh. I.** në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, shqiptohet

### **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI**

**KONFISKOHEN** armët e zjarrit – dhe atë pistoletën e llojit “SIG SAUER P 226”, me numër serik Z5292, prodhim zviceran me kalibër 9x19 mm dhe pistoleta e llojit “Çeshka Zbrojevka”, me numër serik 722276, prodhim çekoslovak, me kalibër 7.65 Br S & B 15, sipas Listës së armëve të konfiskuara të Policisë së Kosovës Stacioni Policor Pejë, me numër të rastit 2016-DC-168 i datës 03.05.2016, dhe **URDHËROHET** që armët e konfiskuara të shkatërrohen.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP.I.142/16 të datë 24.06.2016 kundër të pandehurve I. H. dhe Sh. I., që të dy nga Peja, të akuzuar secili veç e veç për shkak të veprës penale *përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 375 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 20.09.2016 në praninë e Prokurorit të Shtetit, të të pandehurit I. H., mbrojtësit të tij avokat Z. B. dhe të pandehurit Sh. I. dhe mbrojtësit të tij avokat A. Sh.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit që të dy të pandehurit u deklaruan fajtor për veprat penale me të cilat akuzohen.

Pas deklarimit të pandehurve, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, dhe propozimit të mbrojtësve që pranimi i fajësisë të aprovohet, Gjykata konstatoj se të pandehurit pranuan fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurve se e pranojnë fajësinë, në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurve I. H. dhe Sh. I. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale *përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së*.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprën e kryer.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurve, kështu që të njëjti janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata ka vlerësuar sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit fillestar duke pranuar fajësinë dhe duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre. Si rrethana rënduese për të pandehurin I gjykata gjen dënimin e tij të mëhershëm të lëshuar nga kjo gjykatë me numër PKR.nr 151/16 të datës 26.07.2016, për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve, ndërsa për të pandehurin Sh gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata për të pandehurit I. H. dhe Sh. I. ka aplikuar zbutjen e dënimit nga neni 75 i KPRK-së dhe ka ulë dënimin nën minimumin ligjor, duke vlerësuar pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, e me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurve është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor për të pandehurin I. H. në shumën prej 50 euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Duke u bazuar në nenin 453 par. 4 të KPPRK-se, gjykata të pandehurin Sh. I. e liron nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale meqenëse i njëjti është pensionist invalidor i UÇK-së.

Ndaj të pandehurve I. H. dhe Sh. I. në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së sendit, respektivisht konfiskimi i armëve – dhe atë pistoletën e llojit “SIG SAUER P 226”, me numër serik Z5292, prodhim zviceran me kalibër 9x19mm dhe pistoleta e llojit “Çeshka Zbrojevka”, me numër serik 722276, prodhim çekoslovak, me kalibër 7.65 Br S & B 15, duke pas parasysh se arma i nënshtrohet konfiskimit të detyrueshëm sipas nenit 374 par. 3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr.138/16 më datë 20.09.2016**

**Sekretarja Juridike**

**Kryetari i Trupit Gjykes**

\_\_\_\_\_  
**Gjyljeta Çorkadiu**

\_\_\_\_\_  
**Kreshnik Radoniqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.